



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 290/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Klinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Klinë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1200 (njëmijëedyqind ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 21.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 19.10.2013, rreth orës 12:00, anëtarë të PDK-së, kanë vendosur posterë të kandidatit për kryetar komune Sokol Bashota nga ky subjekt, në gjeneratorin e objektit të Komunës së Klinës, i cili gjendet brenda hapësirës së kuvendit komunal në Klinë. Parashtruesi i ankesës me këtë rast konsideron se është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, dhe neni 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik brenda afatit të, PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV, janë të pabaza, lidhur me shkeljen e rregullave të përcaktuara me nenin 33 pika b të LZP-së ose neni 3 pika b të Kodit të mirësjelljes së subjekteve politik. Poashtu në përgjigjen në ankesë PDK, thekson se persona të paautorizuar kanë keqpërdor posterin e kandidatit, për kryetar të komunës së Klinës, nga radhët subjektit politik PDK-së, dhe e kanë vendosur në vendin e paautorizuar për të dëmtuar Partinë Demokratike, ndërsa me të kuptuar këtë aktivistet e PDK-së, kanë shkuar në vendin e caktuar dhe e kanë hequr posterin e kandidatit në cilisinë e provës i kanë bashkangjitur përgjigjenë ankesës një fotografi nga vendi i shkeljes së supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e bashkangjitura si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterin i kandidatit për kryetar të komunës së Klinës, Sokol Bashota i subjektit politik të

PDK-së, është i vendosur në gjenerator të objektit të komunës, që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neni 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalojnë vendosjen e pllakateve , posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se, subjekti politik PDK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se poster i kandidatit të PDK-së, për Kryetar të Komunës së Klinës, ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave si dhe atë se subjekti i njëjtë politik ka bërë shkeljes të njëjtës natyre edhe më parë në këto zgjedhje. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë posterin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti politik PDK-ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që poster i kandidatit për kryetar komune, të PDK-së, është i vendosur në gjeneratorin e objektit të komunës, që është ndaluar me dispozitat e cituara më lart, për lartësinë e gjobës së shqiptuar ka ndikuar veprimet menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë andaj në kuptim të, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 290/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*